

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 173/2014 “PËR DISIPLINËN NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, duke plotësuar disa mangësi që janë evidentuar, ndër vite, gjatë zbatimit të tij.

Nëpërmjet tij synohet rritja e disiplinës në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si një nga shtyllat kryesore të saj. Disiplina, zinxhiri i komandimit dhe zbatimi i urdhrave të eprorit me përpikëri dhe në një kohë sa më të shkurtër janë çelësi i funksionimit të një strukture të armatosur me një mision të rëndësishëm, siç është sigurimi i pavarësisë së vendit, si dhe mbrojtja e tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues.

Për vetë objektivin e rëndësishëm që kanë Forcat e Armatosura, rregullimi i veçantë për sa i përket administrimit të jetës së përditshme është i domosdoshëm. Pikërisht, ky projektligj do të garantojë përmirësimin e funksionimit të Forcave të Armatosura, duke garantuar rendin dhe disiplinën e ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve do të bëhet i mundur përcaktimi i një liste gjithëpërfshirëse, sa i përket alternativave të shkeljeve që mund të kryen gjatë ushtrimit të detyrës nga ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, janë shtuar llojet e masave disiplinore për secilën shkelje, duke i mundur vendimmarrësit dhënien e një mase disiplinore në proporcion të drejtë me rëndësinë e shkeljes.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2020, për Ministrinë e Mbrojtjes.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësia e këtij projektligji është rritja e efikasitetit të proceseve të përditshme të Forcave të Armatosura dhe përmirësimi i disiplinës.

Ligji nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” ka si objekt përcaktimin e normave dhe rregullave të hollësishme të sjelljes e të etikës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, i kategorive dhe llojeve të shkeljeve, masave disiplinore, si dhe i autoriteteve kompetente për dhënien e tyre.

Problematikat kryesore të cilat janë evidentuar nga zbatimi në praktikë i ligjit aktual, janë raste shkeljesh të cilat nuk janë të përcaktuara si të tilla, por që në vetvete përbëjnë sjellje të cilat cenojnë etikën dhe disiplinën. Për këtë arsye, është vlerësuar e nevojshme të përditësohet lista me shkelje për secilën kategori duke shtuar shkelje të reja apo duke rikategorizuar disa prej tyre. Gjithashtu, ka pasur ndryshime sa i përket llojit të masave disiplinore, si dhe autoriteteve kompetente për dhënien e tyre. Për rrjedhojë, organi vendimmarrës ka më shumë alternativa zgjedhje midis masave disiplinore për shkeljet konkrete.

Ndër të tjera, ky projektligj vjen si nevojë e zgjidhjes të problematikave të reja, të patrajuara nga ligji aktual, i cili nuk është ndryshuar që me miratimin e tij, pra në vitin 2014. Dinamika të reja, të cilat kanë penguar realizimin e përfundimit të disiplinës në Forcat e Armatosura, sipas ligjit 173/2014, adresohen nga ky projektligj që njëkohësisht shton llojet e shkeljeve, por në të njëjtën kohë edhe përshkallëzon masat ndaj tyre. Projektligji, krahas masave dhe shkeljeve të reja bën edhe një rikategorizim të llojit të shkeljeve të parashikuara nga ligji aktual dhe cilësimit të tyre, duke kushtëzuar kështu edhe masën që do të merret ndaj tyre nga organi kompetent.

Këto ndryshime do të bëjnë të mundur plotësimin e mangësive të ligjit aktual, duke sjellë si pasojë forcimin e disiplinës ushtarake dhe rendit ushtarak që përbëjnë edhe vetë qëllimin e këtij ligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektaktit

Projektligji përbëhet në tërësi nga 12 nene, nëpërmjet të cilave bëhen disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Në nenin 1 përcaktohet shtimi i fjalës “studentët”, në nenin 4, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Bazuar në vendimin e

Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 19.2.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, duke filluar nga tetori i këtij viti, Akademia e Forcave të Armatosura do të hapë programet e studimit. Rrjedhimisht, është gjykuar e nevojshme që edhe studentët ushtarakë të jenë subjekt i këtij ligji.

Në nenin 2 përcaktohen shtesat dhe ndryshimet që do të bëhen në nenin 7 të ligjit aktual. Sipas këtyre ndryshimeve, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, jep masa shumë të rënda disiplinore, për nënoficerët dhe ushtarët e Forcave të Armatosura, me përjashtim të masave shumë të rënda “Vërejtje me paralajmërim” dhe “Ulje në pagë”, për tetarët dhe nëntetarët, si dhe për ushtarët me grada “Ushtar I deri Ushtar IV”, të cilët janë në varësi të komandantëve të Forcave dhe strukturave mbështetëse. Gjithashtu, është riformuluar pika 2 e nenit 7, duke përcaktuar se ndaj oficerëve me grada më të larta, do të jepen vetëm masat disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, “Ulje e gradës”, “Ndalimi për gradim” dhe “Shkarkimi dhe lirimi nga Forcat e Armatosura”.

Neni 3 përcakton se në nenin 9 do të shtohen fjalët “...dhe Komandat e Forcave dhe strukturave mbështetëse...”. Nëpërmjet këtij përcaktimi, Komisioni i Lartë Disiplinor nuk do të ngrihet vetëm në Shtabin e Përgjithshëm, por edhe në Komandat e Forcave dhe strukturave mbështetëse.

Në nenin 4, ku përcaktohen shtesat dhe ndryshimet e nenit 11 të ligjit, renditen shkeljet disiplinore të lehta. Lista është përditësuar, duke shtuar shkelje të reja, duke ndryshuar shkeljet aktuale dhe duke zhvendosur shkelje nga të lehta në të rënda dhe anasjelltas. Përkatesisht:

Shkelje të reja:

1. shkrepija e armës nga pakujdesia, e cila nuk shkakton dëme materiale apo lëndime njerëzore;
2. mosmirëmbajtja dhe/ose dëmtimi i armës, municionit, teknikës, pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura nga pakujdesia, që shkakton humbjen e përkohshme të gatishmërisë teknike të tyre.

Shkelje të cilat ishin pjesë e listës, por kanë pësuar ndryshime:

1. publikimi i paautorizuar në rrjetet sociale të pamjeve personale apo të çdo efektivit të Forcave të Armatosura me armatim ushtarak, simbole dhe mjete teknike ushtarake;
2. pranimi i dhuratave ose ndonjë përfitimi nga vartësit apo personave të tjerë në lidhje me shërbimin ushtarak, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Shkelje të cilat, pas rikategorizimit, kanë kaluar nga shkelje të lehta në shkelje të rënda:

1. mosraportimi i përdorimit të armës së zjarrit;

2. moszbatimi i detyrave të dhëna nga eprori i drejtpërdrejtë ose jo;
3. prishja e qetësisë në njësi ose reparte ushtarake, kur nuk përbën vepër penale.
4. veprime me dashje, të cilat çojnë në paaftësi fizike të vetë ushtarakut, me qëllim shmangien nga detyrat e ngarkuara.

Shkelje të cilat, pas rikategorizimit, kanë kaluar nga shkelje të rënda në shkelje të lehta:

1. lëvizja e gabuar nga pakujdesia e teknikës ose mjetit tokësor, detar, ajror nga ushtaraku, kur nuk përbën vepër penale;
2. përdorimi i lojërave të bixhozit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale.

Gjithashtu, në nenin 11 të ligjit është shtuar një paragraf, i cili përcakton se:

“Kryerja e shkeljes së tretë të lehtë disiplinore brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet e rënda, sipas pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji.”

Nëpërmjet këtij përcaktimi synohet të parandalohet përsëritja e shkeljeve disiplinore nga i njëjti person pasi duke ndryshuar kategorinë e shkeljes, ndryshon edhe masa disiplinore që do merret për të.

Në nenin 5, ku përcaktohen shtesa dhe ndryshimet e bëra në nenin 12, renditen shkeljet disiplinore të rënda. Lista është përditësuar, duke shtuar shkelje të reja dhe duke zhvendosur shkelje nga të rënda në shumë të rënda. Përkatësisht:

Shkelje të reja:

1. mosrespektimi i orarit të punës më shumë se një herë brenda një periudhe njëmuajore;
2. ushtrimi i presionit ndaj vartësve për përfitime personale, kur nuk përbën vepër penale;
3. “Ngacmim” në çdo formë sjelljeje të padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtëruës, përçmues apo fyes për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Shkelje të cilat ishin pjesë e listës, por kanë pësuar ndryshime:

1. shkelja me qëllim e rregullave të mbajtjes, mirëmbajtjes, ruajtjes dhe përdorimit të armatimit, municionit, teknikës, pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura.

Shkelje të cilat, pas rikategorizimit, kanë kaluar në shkelje shumë të rënda:

1. dhënia ose mundësimi i dhënies së informacioneve me karakter ushtarak, për të cilat ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme, personave të paaautorizuar ose medias, kur nuk përbën vepër penale.

2. përdorimi i pajisjeve elektronike për regjistrimin dhe/ose filmimin e bisedës me eprorët, vartësit dhe kolegët, për çfarëdolloj arsyeje, pa dijeninë e tyre, kur nuk përbën veprë penale dhe përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Gjithashtu, janë shtuar dy paragrafë, duke përcaktuar, si më poshtë:

Së pari, shkeljet disiplinore: “shprehja e kritikave publike ndaj FA-së, në formë shkresore, elektronike apo verbale, që cenon imazhin e institucionit apo personalitetin e ushtarakëve të tjerë të FA-së”; “fshehja, ndryshimi ose asgjësimi i dokumenteve zyrtare në formë shkresore ose elektronike”; “dhënia me dashje e informacionit të gabuar, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”; “ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune ndaj një personi tjetër, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari”; “ngacmimet seksuale, në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale apo fizike të një natyre seksuale, të kryera gjatë ose jashtë orarit të punës, kur nuk përbëjnë veprë penale”, të kryera gjatë trajnimeve, kualifikimeve, arsimimit, shërbimit, stërvitjes, misionit jashtë vendit apo të kryera nga oficerë me grada madhore, kategorizohen si shkelje shumë të rënda disiplinore dhe masa e dhënë për to do të jetë sipas masave disiplinore për shkelje shumë të rënda.

Së dyti, kryerja e shkeljes së tretë të rëndë disiplinore, brenda një periudhe njëvjeçare, konsiderohet shkelje shumë e rëndë disiplinore dhe masa e dhënë për këtë shkelje do të jetë në përputhje me masat për shkeljet shumë të rënda.

Në nenin 6, ku përcaktohen shtesa dhe ndryshimet e bëra në nenin 13, renditen shkeljet disiplinore shumë të rënda. Lista është përditësuar, duke shtuar shkelje të reja, duke ndryshuar shkeljet aktuale. Përkatësisht:

Shkelje të reja:

1. ngacmimet seksuale, në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale apo fizike të një natyre seksuale, të kryera nga eprori ndaj vartësit ose ndaj ushtarakut me gradë më të ulët, gjatë ose jashtë orarit të punës, kur nuk përbën veprë penale;
2. organizimi i lojërave të bixhozit në ambientet ushtarake, me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale;
3. ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune, sjellja fyese apo kërcënuese ndaj një personi tjetër, kur kjo ushtrohet nga oficerët aktivë me grada të larta ose madhore të FA-së ose kur kryhet ndaj eprorit të drejtpërdrejtë, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari;
4. refuzimi i zbatimit të urdhrit apo një vendimi të ligjshëm të dhënë nga eprori;
5. mosmarrja e masave të duhura të organizimit dhe sigurisë nga drejtuesit e njërive dhe reparteve të FA-së, kur kjo ka sjellë pasoja të rënda materiale.

Shkelje të cilat ishin pjesë e listës, por kanë pësuar ndryshime:

1. Ushtrimi i funksioneve ose mospërmbushja e detyrave që sjellin cenim të operacionalitetit, gatishmërisë dhe sigurisë në Forcat e Armatosura.

Nëpërmjet nenit 7, ku përcaktohen ndryshimet e bëra në nenin 14, është shtuar një masë disiplinore për shkeljet e lehta “Stërvitje disiplinuese”, e cila është *masa që i jepet verbalisht nga autoriteti përgjegjës ushtarakut të Forcave të Armatosura brenda natyrës së elementeve të stërvitjes, të tilla si; vrapim, pompa, palosje, apo ndonjë stërvitje tjetër të përshtatshme gjatë orarit të punës*. Gjithashtu, janë shtuar disa masa disiplinore për shkeljet shumë të rënda. Duke mbajtur në konsideratë faktin që secili rast ka veçoritë e tij, shtimi i alternativave të masave disiplinore bën të mundur që organi vendimmarrës të japë një vendim sa më të drejtë dhe proporcional me rëndësinë e shkeljes.

Sipas nenit 8, ku përcaktohen ndryshimet e nenit 18 të ligjit aktual, në rastet e kryerjes së një shkeljeje të lehtë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me masat “Qortimi” ose “Detyra shtesë”. Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me masën “Vërejtje me shkrim” ose “Kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar” dhe në rastet e kryerjes së një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave lehtësuese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me masën “Vërejtje me paralajmërim” ose “Ulje në detyrë”.

Ndërsa në nenin 9 bëhen shtesa dhe ndryshime në listën e rrethanave rënduese, si dhe përcaktohen mundësitë e zgjedhjes midis masave disiplinore për shkelje disiplinore të kryera në kushtet e rrethanave rënduese.

Së pari, riformulohet pika “gj” me përmbajtjen: *“Kryerja e shkeljes disiplinore gjatë trajnimeve, kualifikimeve, arsimimit, shërbimit, stërvitjes apo misionit jashtë vendit.” Si dhe shtohen “Kryerja e shkeljes disiplinore nga oficerë me grada të larta”; “Kryerja e shkeljes disiplinore në situatë lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore”; “Kryerja e shkeljes disiplinore gjatë operacioneve apo misioneve brenda vendit.”*

Së dyti, në rastet e kryerjes së një shkeljeje të lehtë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me masën “Punë jashtë orarit” ose “Stërvitje disiplinuese”; Në rastet e kryerjes së një shkeljeje të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me masën “Ndalim disiplinor” ose “Gjobitje në pagë”; Në rastet e kryerjes së një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, në kushtet e rrethanave rënduese, ushtaraku i Forcave të Armatosura ndëshkohet me masën “Ulje e pagës”, “Ndalimi për gradim”, “Ulje në gradë” ose “Shkarkimi dhe lirimi nga Forcat e Armatosura”.

Nëpërmjet nenit 10 bëhet një shtesë në nenin 23 të ligjit aktual, duke përcaktuar autoritetin, i cili urdhëron heqjen e masës disiplinore. Kjo shtesë është propozuar, pasi ometimi ligjor, sa i përket organit kompetent për të urdhëruar heqjen e masave disiplinore të parashkuara, ka sjellë në praktikë zgjidhje të ndryshme për situata të ngjashme.

Në nenin 11 përcaktohet ndryshimi i nenit 25 të ligjit, duke shtuar masat shumë të rënda, të dhëna nga komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse apo strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në listën e

masave për të cilat mund të bëhet ankim administrativ pranë shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Mbrojtjes.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Olta Xhaçka

Konceptoi: R. Hoxha
Pranoi: A. Gjilani
Miratoi: I. Shehu
1K, datë 18.6.2020